

NJËRËZ



Botim i Grupit Shqiptar për të Drejtat e Njeriut
Rr. "Dëshmorët e 4 shkurtit", p. 7/1, shk. 1, ap. 30. Tiranë.
E-mail: info@ahrg-al.org <http://www.ahrg-al.org>

Nr. 2 / 2012

Mbështetur nga UNDEF
Supported by UNDEF

UNDEF



The United Nations
Democracy Fund



“Gadishulli” i Minoriteteve

Elsa Ballauri

Drejtoresh e Ekzekutive e GSHDNJ

Akademia e Minoriteteve është një nga projektet më të rëndësishme të ngritura për minoritetet në Shqipëri. Qëllimi për t'i bashkuar të gjitha grupet e ndryshme etnike, kulturore, gjinore në një “gadishull” malor interesant dhe plot kuriozitete siç është Voskopoja, ka qënë një nga idetë e hershme të organizatës që unë drejtoj. E konsideroj gadishull komunitetin tonë të minoriteteve, ku më shumë ndjehemi të pasigurt nga uji që na rrethon dhe vetëm pak siguri na krijon një copkë tokë. Ky është ende fati minoriteteve në Shqipëri.

Por na duhet të jemi të gjithë bashkë për ta ndërtuar tokën rreth gadishullit që bazamenti të bëhet i fuqishëm dhe ne të komunikojmë me pjesën tjetër të shoqërisë pa rreziqe në mes. Të komunikojmë me politikën dhe strategjitë e qeverisë shqiptare, pa u lagur dhe rrezikuar nga mbytja.

Akademia ka mbledhur të rinj dhe jo të rinj, ka mbledhur njerëz të përkushtuar, të interesuar, misionarë të të drejtave të njeriut. Të rinjtë marrin edukim mbi të drejtat e njeriut dhe mësojnë se si të punojnë në komunitet. Bashkëpunimi me qeverinë qendrore dhe lokale do ta nxitë iniciativën dhe do të realizojë sfidat. Kështu shpresojmë, kështu duhet të ndodhë. Ne do të përpiqemi për këtë.

Falenderim i veçantë i shkon UNDEF që realizoi këtë ëndërr. Një rast optimist kur ëndërrat realizohen.

“The peninsula” of Minorities

Elsa Ballauri

Executive Director of the Albanian Human Rights Group (AHRG)

The Minority Rights Academy is one of the most important projects dealing directly with minorities in Albania. The cause of gathering all diverse ethnic, cultural, and gender groups in an interesting and intriguing “peninsula” on a mountain called Voskopoja. This idea has been one of the earliest aspirations of the organization I run. I consider our community of minorities a peninsula, where we feel uncertainty coming all around us from the water borders and only a little safety blooming from the land border. This is still the fate of the minorities in Albania. But we have to be united to build the land around the peninsula so the foundation will be strong and the communication with the rest of the society will be danger-less. We have to communicate with the politics and strategies of the Albanian government, without getting wet . . . without fear of drowning. The Academy has assembled dedicated, interested missionaries of human rights of all age groups. The younger ones have benefitted from the human rights lessons they are taught, and hands on training on how to work in a community. Collaboration with the central and local government will encourage the initiative and will achieve the goals and overcome the challenges. That is what we hope . . . that is what should happen. We will do our best to accomplish this.

Special thanks are attributed to United Nations Democracy Fund (UNDEF) that made this dream come true. This makes us optimistic.



Akademia e të Drejtave të Minoriteteve

“Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut” organizoi për herë të parë në Voskopojë “Akademinë e të Drejtave të Minoriteteve” për vitin 2012, si një nga projektet më të rëndësishme të ngritura për Minoritetet në Shqipëri. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të disa Minoriteteve si Greke, Serbo-Malazeze, Boshnjake, Rome, Egjiptiane, Vllehe, Maqedonase, , LGBT, lektorë ,studentë e të ftuar të ndryshëm. Aktiviteti zgjati pesë ditë dhe u zhvillua nga data 25 deri më 30 Qershor, me një numër pjesëmarrësish prej 40-50 veta.

Dita e parë e trajnimit u hap nga Znj. Elsa Ballauri, Drejtore e “Grupit Shqiptar i të Drejtave të Njeriut” e cila bëri prezantimin e Akademisë dhe qëllimet e saj , gjithashtu dhe prezantimin e pjesëmarrësve të minoriteteve duke u njohur me situatën dhe problematikat e tyre në Shqipëri.

I pranishëm në ditën e parë të trajnimit ishte edhe Ambasadori holandez në Shqipëri Z. Henk Van Den Doolu i cili u përqëndrua në temën e demokracisë funksionale, avantazhet dhe disavantazhet dhe një sy krahasues mbi atë që ndodh në Shqipëri.

Temë e trajtuar me shumë seriozitet dhe mjaft e rëndësishme për pjesëmarrësit ishte edhe fjala e mbajtur nga shefi i EULEX për Kosovën Z. Bernd Borchardt, temë e fokusuar mbi ilustracionin dhe mbi mënyrat sesi duhet implementuar ai në të gjitha ato vende që nuk i shköpusin dot marrëdhëniet me të shkuarën për shkak të krimeve që vazhdojnë të jenë të fshehura për sytë e publikut.

Të drejtat e njeriut dhe të drejtat kolektive

Ajo që pa dyshim u quajt edhe krenaria e këtij trajnimi ishte pjesëmarrja e Profesorit për të “Drejtat e Njeriut” në Universitetin e Utikas në Nju Jork Z. Theodore Orlin. Profesor prej më shumë se tre dekadash, Orlin e përqëndroi leksionin e tij tek diferenca për të drejta e njeriut dhe të drejtat kolektive. Leksionet e Orlin përfshinë në diskutime pjesëmarrësit për mënyrën sesi ata shihnin njërin nga problemet në shoqëri nga këndvështrimet e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu Znj. Elira Kokona , juriste dhe specialiste për çështjet e Strasburgut e përqëndroi shpjegimin e asaj çfarë është Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe sesi individët , përfaqësues të minoriteteve mund të ankohen tek ajo në rastet kur u shkelen të drejtat. Temë tjetër që i përfshiu të gjithë pjesëmarrësit në diskutim ishte dhe “Komunikimi në komunitetet e mbyllura” e mbajtur nga Profetori i gazetarisë Z. Zyllyftar Bregu.

Të qenit pjesë e shoqërisë do të thotë të zgjedhësh atë që ke prioritet

Gjatë trajnimit Z. Vasil Sterjovski përfaqësues i Komunitetit Maqedonas, ngriti çështjen e gjuhës maqedonase dhe faktin që ata nuk e ngrënë dot një shkollë maqedonisht në Korçë pa ndihmën e shtetit. Të pranishmëve iu shpjegua se komuniteti gëzon të drejta në ven-



din ku ai është i vendosur prej brezash, në të kundërt në rastet e migrameve ai i humbet disi këto të drejta për shkak të asimilimeve.

Në fund të gjithë pjesëmarrësve iu sqarua se në rastet kur komunitete të caktuara vendosin të lëvizin nga vendi i tyre i përqëndrimit ato humbasin të drejtën për t'i kërkuar shtetit shkollim në gjuhën e tyre pranë qendrave të tjera të banuara, por ndërkohë mund të bashkohen si komunitet i së njëjtës etni dhe të ngrenë shkolla private në gjuhën përkatëse. Gjithashtu mund të vazhdojnë të llobojnë për këto të drejta.

E drejta për mbrojtjen nga diskriminimi

Pjesë e referimit gjatë trajnimit ishte dhe Komisionerja e Zyrës së Anti-diskriminimit Znj. Irma Baraku, e cila referoi rolin e Zyrës Anti-diskriminimit dhe shpjegoi sesi zyra është në funksion të atyre të gjithë individëve që kërkojnë mbrojtje nga diskriminimi.

Nga grupet e komuniteteve pjesëmarrëse në aktivitet, ata që kishin pasur një eksperiencë bashkëpunimi me zyrën ishin të rinjtë e Komunitetit Homoseksual në Shqipëri mbi të cilët ishin hedhur akuza të drejtpërdrejta deri në asgjësim. Komuniteti LGBT u shpreh i kënaqur për rolin e kësaj zyre. Ndërkohë Znj. Baraku referoi edhe për grupet e tjera të diskriminuara të cilat për efekt racizmi largohen nga puna ose nuk pranohen fare në punë.

Z. Kujtim Zelia, Znj. Selvie Rrushi, Znj. Meleqe Renja, Z. Pavlo Jakolja, Z. Aqif Buka, Z. Esad Kapedani, Z. Niko Simaku, Z. Robert Çollaku e të tjerë përfaqësues të njohur të minoriteteve, diskutuan se cilat ishin problematikat, pengesat dhe sugjeruan çështje të ndryshme për të zgjidhur situatën e këtyre minoriteteve dhe komuniteteve në Shqipëri. Organizatat LGBT informuan të pranishmit për punën dhe aktivitetet e tyre pasi ishte hera e parë që ato gjendeshin në komunitetin e të tjerëve.

Një aspekt shumë i veçantë ishte edhe ekspozita e punimeve të dorës dhe ekspozimi i disa sendeve, flajmujve, qëndismave të Komunitetit Rom, të ruajtura brez pas brezi. Ekspozimi i tyre nuk ishte i rëndësishëm vetëm për pjesëmarrësit, por edhe për turistët e tjerë që ishin të pranishëm në fshatin turistik "Akademia".

Po kështu Shoqata "No Limits" solli një ekspozitë me punime të të burgosurve në disa nga burgjet e Shqipërisë. Synimi i këtij projekti ishte të ndihmonte të burgosurat e dënuara për një kohë të gjatë nga ana ekonomike. Shumë prej pjesëmarrësve blenë mjaft prej këtyre sendeve, paratë e të cilave ndonjëherë nuk shkojnë vetëm në xhepin e të burgosurave, por edhe të familjeve të tyre. Ekspozita me piktura e Znj. Linda Trajçe ishte një tjetër pjesë e bukur e aktivitetit, ekspozitë e cila u kurua nga piktorja Jona Dividi.

Aktivitetet artistike

Programi i trajnimit ishte menduar të mbaronte në orën 18.00, ku mbrëmjet ishin organizuar me aktivitete artistike dhe Kinema verore me shfaqjen e disa filmave mjaft të njohur. Filmi që spikati ishte një realizim gjerman me titullin "Jeta e të tjerëve", skenari dhe regjia nga Florian Henckel von Donnersmarck. I konsideruar si një nga majat e kinemasë gjermane për skenarin e mrekullueshëm bazuar në histori të vërtetë me subjekt nga e shkuara komuniste e Gjermanisë Lindore dhe mënyrës sesi Stasi kontrollonte jetën e popullit gjerman, sidomos të intelektualëve, filmi la mbresa të jashtëzakonshme tek pjesëmarrësit, një pjesë e mirë e të cilëve e kanë përjetuar këtë eksperiencë në sistemin monist në Shqipëri.


Edhe pse filmat u shfaqën në një orë të vonë për shkak të vetë dinamikës së ditës dhe programit të ngjeshur, u mirëpritën nga pjesëmarrësit. Ndërsa filmi më i rëndë për të cilin Profesor Theodore Orlin paralajmëroi për dhunën dhe skenat makabre ishte filmi i bazuar mbi jetën e komunitetit Tamil në Indi. Filmi u soll jo pa qëllim nga Profesor Orlin dhe shërbeu për të ndihmuar pjesëmarrësit të ndanin brenda vetes nëse ajo që ndodh në Shqipëri është diskriminim i qëllimshëm apo diskriminim për shkak të neglizhencës së shtetit dhe mungesë e politikave të mirëfillta për këto komunitete.

Në ditën e pestë dhe të fundit në përmblyllje të aktivitetit, të gjithë pjesëmarrësve iu bë prezantimi i Deklaratës përmbledhëse, qëllimet dhe objektivat e saj të cilat do t'i prezantohen qeverisë aktuale.



Lista e Shoqatave pjesëmarrëse të Rrjetit të Minoriteteve

- 1 Shoqata Rome "Distuni Albania"
- 2 Shoqata - Rromano-Kham
- 3 Shoqata "Për një të ardhme të Romëve"
- 4 Shoqata "Gruaja Rome e së Nesërme"
- 5 Bashkimi Demokratik i Romëve në Shqipëri, "Amaro Dives"
- 6 Shoqata Unioni i Romëve të Shqipërisë "Amaro-Drom"
- 7 Shoqata egjiptiane "Kabaja"
- 8 Shoqata ballkano egjiptiane "Sfniksi",
- 9 Shoqata Boshnjake Zambak
- 10 Moraca – Rozafa/ shoqata Serbo-Malazeze, Shkodër
- 11 Shoqata "Zambaku - Boshnjakët e Shqipërisë"
- 12 Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT
- 13 Shoqata Maqedonase "SONCE"
- 14 IRSH Shkoder
- 15 Aroman D'ALBANIA, shoqatë e Arumnëve/Vllehëve
- 16 Forumi Rinor Rom
- 17 Cigan Muzic
- 18 Shoqata për të drejtat e Gruas Rome
- 19 Shoqata Rome "Zemra e Nënës"
- 20 Omonia / Minoriteti Grek



thënie

Mbrojtja e të drejtave të të tjerëve është fundi më fisnik dhe i bukur i një qenie njerëzore.

Khalil Gibran

Asgjë nuk është e pandryshueshme, përveç të drejtave të natyrishtme dhe të patjetërsueshme të njeriut.

Tomas Xheferson

Konsiderojini të drejtat e të tjerëve para ndjenjave tuaja, dhe ndjenjat e të tjerëve para të drejtave tuaja.

Xhon Uden

Potencialisht, një qeveri është kërcënimi më i rrezikshëm për të drejtat e njeriut: ajo mban një monopol ligjor për përdorimin e forcës fizike ndaj viktimave të çarmatosura me ligj.

Ayn Rand

Në ligj një njeri është fajtor kur ai shkel të drejtat e të tjerëve. Në etikë ai është fajtor nëse edhe vetëm mendon për të bërë kështu.

Emanuel Kant

Ne kurri nuk do të kemi qytetërim të vërtetë, pa mësuar të njohim të drejtat e të tjerëve.

Uill Roxhers

